

URDHËR
Nr. 170, datë 3.3.2021

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, ‘Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, zëvendësministrit të Brendshëm, z. Andi Mahila, për këto çështje:

- a) trajtimin dhe ndjekjen e procedurave për fitimin, rifitimin dhe heqjen e shtetësisë shqiptare;
- b) nënshkrimin dhe paraqitjen e kërkesës, së bashku me dokumentacionin shoqërues për rifitimin dhe heqjen e shtetësisë shqiptare pranë Presidentit të Republikës;
- c) trajtimin dhe nënshkrimin e kërkesave për informacion nga persona fizikë dhe juridikë, shtetas shqiptarë dhe/ose të huaj, që kanë të bëjnë me shtetësinë shqiptare.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm, z. Andi Mahila.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi